



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority

Vendimi Nr.35/24
Datë: 04.04.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 04.04.2024, mori këtë;

VENDIM

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me blerjen e 100% të aksioneve nga Vocatus Investment a.s., mbi Sellier & Bellot a.s., dhe në mënyrë indirekte të Sellier & Bellot Trade a.s., që janë në pronësi të CBC Europe S.ä.r.l.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55.1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 09.02.2024, ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 78/24-11/H për Njoftim të Përqendrimit lidhur me blerjen e 100% të aksioneve nga ndërmarrja Vocatus Investment mbi ndërmarrjen Sellier & Bellot a.s., si dhe në mënyrë indirekt 100% të aksioneve të ndërmarrjes së ndërlidhur Sellier & Bellot Trade a.s.

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 05.03.2024
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 06.03.2024
3. Palët kanë nënshkruar Marrëveshje lidhur me shitblerjen e aksioneve të datës 18 dhjetor 2023, nga Vocatus Investment a.s., (blerës) i cili do të blejë të gjitha aksionet e Sellier & Bellot a.s., dhe në mënyrë indirekte të Sellier & Bellot Trade a.s., (kompanitë e synuara), që janë në pronësi të CBC Europe S.ä.r.l, (shitës).

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
3. Marrëveshja e nënshkruar me 18.12.2023 e lidhur mes palëve në Përqendrim.

Palët në Përqendrim

Vocatus Investment a.s., me seli në sheshin e Republikës 2090 /3a, Nové Město, 110 00 Pragë 1, Republika Çeke, me numër identifikues ID Nr:19417772, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës Komunale në Pragë, Seksioni B Dosja 28195 (blerësi ose parashtruesi i kërkesës) e cila është nën pronësi të ndërmarrjes Colt CZ Group SE, më zyrë të regjistruar në sheshin e Republikës 2090 3a, Nové Město, 110 00 Pragë 1, Republika Çeke, ID Nr: 29151961, regjistruar në regjistrin komercial të Gjykatës në Pragë, Seksioni H, Dosja 962, Vocatus Investment a.s., u krijua vetëm për qëllim të zbatimit të transaksionit të propozuar dhe nuk është angazhuar në aktivitete tregtare.

Colt CZ është një kompani e tregtuar publikisht në Bursën e Pragës me 25% të aksioneve, ndërsa 75 % të aksioneve zotërohen dhe kontrollohen nga René Holeček.

Colt CZ së bashku me kompanitë e tij të ndërlidhura ('Colt CZ Group'), është një prodhues çek i armëve të zjarrit, aksesoreve taktikë, në një masë më të vogël, municioneve për ushtri, organeve të rendit, gjuetisë, gjuajtje sportive dhe përdorime të tjera komerciale me aktivitete në mbarë botën. Aksionari kryesor i Colt CZ është Česká zbrojovka Partners SE, që zotëron një shumicë aksionesh prej 75.40% ndërsa pjesa e mbetur prej 24.60% tregtohet publikisht, e përbërë një pronësi të lirë.

Colt CZ Group është aktiv në industrinë e armëve të zjarrit, me produktet e tij të tregtuara dhe të shitura kryesisht nën markat e njohura si Colt, CZ (Česká zbrojovka), Colt Canada, CZ-USA, Dan Wesson dhe 4M Systems, Grupi përbehet nga disa kompani, duke përfshirë Colt/ Česká zbrojovka, Colt Canada, CZ-USA, 4M Systems, Spuhr i Dalby, swissAA (saltech AG) dhe Colt CZ Defense Solutions.

Grupi Colt CZ është aktiv në:

1. prodhimin e armëve të vogla pistoleta, pushkë, mitraloz, pushkë gjahu, pushkë snajper etj.
2. prodhimi i armëve të lehta, granatahedhës, raketahedhës – RPG etj.
3. prodhimi i komponentëve për armë të vogla dhe të lehta.

4. prodhimi i municioneve për arme të vogla nëpërmjet entitetit zviceran Saltech.
5. prodhimi i eksploziveve për përdorim ushtarak granata, predha mortajash dhe
6. prodhimi i pajisjeve taktike si jelek balistik, helmeta, uniforma etj.

Colt CZ Group nuk ka ndërmarrje të regjistruar në Kosovë, por ka realizuar të hyra përmes shitjeve/ distributoreve si më poshtë;

1. Poligoni i shenjëtarisë Katana SH.P.K, me numër të biznesit 70673312, me adresë në Kastriot.
2. AFSA ARMS SH.P.K., me numër të biznesit 70720426, me adresë në Prishtinë.

Sellier & Bellot a.s., është ndërmarrje e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Republikës Çeke me seli në Lidická 667,258 01 Vlašim, ID Nr: 28982347, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me Gjykatën Komunale në Pragë, Seksioni B, Dosja 15674 ose (Kompania e Synuar). Sellier & Bellot është një prodhues çek i municioneve të kalibrave të vogël (prodhim i municioneve për armë të lehta) në mbarë botën, si dhe më prodhimin e makinerive për prodhimin e municioneve. Aktualisht është në pronësi të plotë të CBC Europe., e cila është në pronësi të fundit nga CBC Global Ammunition (SHBA). CBC Global Ammunition është një prodhues botëror i municioneve të vogla dhe në një masë shumë të kufizuar të kalibrave të mesëm dhe armëve të vogla.

CBC Europe S.ă.r.l., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila ekziston sipas ligjeve të Mbretërisë së Dukatit të Madh, më seli në Luksemburg 1616, Place de la Gare 5, regjistruar në Regjistrin e Tregtisë të ndërmarrjeve të Luksemburgut (Registre de Commerce et des Sociétés), nën numrin B167046.

Tregu përkatës:

Tregu i produktit, përfshinë prodhimin e municioneve të kalibrave të vegjël dhe shpërndarjen e armeve të vogla.

Tregu gjeografik: në transaksionin e propozuar mund të lihet i hapur.

Analiza e konkurrencës:

Duke marrë parasysh që Kompania e Synuar nuk ishte aktive në Kosovë përgjatë vitit 2022; konsiderohet se nuk ka mbivendosje horizontale ose vertikale, ndërmjet aktiviteteve të palëve dhe transaksioni i propozuar nuk mund të ketë ndonjë efekt të mundshëm në tregun e Kosovës, si rrjedhojë nuk krijon ndonjë shqetësim për konsumatorët në Kosovë.

Në nivel të BE-së, pjesa e tregut e Colt CZ Group në prodhimin e municioneve të armëve të vogla ishte nën 1% të tregut. Në mënyrë të ngjashme, edhe Kompania e Synuar vlerëson se duke pasur parasysh qarkullimin e saj, pozicioni i saj është ende mjaft i parëndësishëm

ne krahasim me prodhuesit e tjerë multimilioner apo edhe miliardë dollarësh aktivë në BE, Për më tepër Kompania e synuar vlerëson se pjesa e saj e tregut është rreth diku më shumë se 10% por më pak se 15% në BE.

Ndërmarrja Sellier & Bellot a.s dhe ndërmarrja Vocatus Investment a.s. edhe pas transaksionit nuk do të kenë shtrirje në tregun e Kosovës, andaj edhe pas transaksionit tregu i Kosovës mbetet i pa ndryshuar.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se COLT CZ Group në transaksion është prezent në Republikën e Kosovës, përmes distributorit të saj të autorizuar. Transaksioni i propozuar nuk paraqet ndonjë shqetësim për konkurrencën në Kosovë. Përqendrimi i Propozuar nuk do të rezultojë në asnjë ndryshim në strukturën e tregut relevant në Kosovë. Ndërmarrja Vocatus Investment dhe as ndërmarrja Sellier & Bellot a.s., nuk ka prezencë apo aktivitete në Kosovë dhe nuk realizon të hyra nga ofrimi i prodhimit dhe shpërndarjes së municionit për armë të lehta për konsumatorët që ndodhen në Kosovë. Përqendrimi i Propozuar nuk do të ndryshojë strukturën ekzistuese të tregut në Kosovë, andaj transaksioni i propozuar nuk do të çojë në parandalim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në Kosovë, në veçanti nuk do të çojë në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese dhe nuk do të ketë asnjë efekt negativ në tregun kosovar.

Kështu që kushtet e konkurrencës do të mbesin të njëjta si para dhe pas transaksionit. Ndërmarrjet e përfshira në Përqendrim nuk do të kenë efekt negativ në tregun kosovar.

Komisioni ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga “Njoftimi” nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI**

Neime Binaku-Isufi
Kryetare




Kaltrina Sela
Zv. Kryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare



Florent Mehmeti
Anëtar



Salihe Gashi Loku
Anëtare



III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva